

# **NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARTAN BROCI**

07/31/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 27.07.2018 për subjektin e rivlerësimit, z.Artan Broci, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 31.07.2018, me shumicë votash vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit , Artan Broci, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Xhensila Pine, znj.Valbona Sanxhaktari relatores, znj. Etleda Çiftja anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.